



Pranimar / Dorezuar Prindjen / Primito Received / Delivered	21.12.2022	2	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKPM/SHIKK	8280/2022	115
Si Prot In Prot Prot No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.727/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1655/2021 të gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 28.10.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.727/2019 të datës 21.11.2019 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted]

kundër organit të punësimit/Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.727/2019 e datës 21.11.2019 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. SHFUQIZOHET Përgjigja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e datës 14.11.2019.

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative që ankuesit t'i bëjnë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 06.04.2017 deri me datë 31.09.2019 për diferencën pagës në vlerën e një (1) koeficienti.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 21.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Sekretarit të Përgjithshëm të datës 14.11.2019, me pretendimin ankimor për kompensimin pagës në mënyrë retroaktive për diferencën e pagesës së koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9), për periudhën kohore nga data 06.04.2017 deri më 31.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.11.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa me datë 05.12.2019 institucioni punëdhënës ka përcjell në Këshill dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 28.10.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1655/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 21.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës të datës 21.11.2019 me shkresat e bashkangjitura; Kërkesën e ankuesit të datës 01.11.2019; Refuzimin e kërkesës së ankuesit e datës 14.11.2019; Akt emërimit të ankuesit të datës 06.04.2017; Vendimin e U.D të Sekretarit të Përgjithshëm i datës 06.04.2017; Rekomandimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 26.04.2017; Kërkesën e ankuesit të datës 29.03.2019; kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.11.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.12.2019; Akt emërimit ankuesit të datës 01.04.2012; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 20.12.2013; Listën e pagave të ankuesit për periudhën kohore janar-tetor 2019; Zarfë postar me shifër R7592082; njoftimin e datës 16.12.2019; Fletë kthesa e datës 27.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit A.nr.727/2019 e datës 21.11.2019, është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave në bazë të administrimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 01.04.2012 është i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në pozitën e punës "Kordinator i të hyrave në MASHT" në kuadër të Departamentit të Financave dhe Personalit me koeficient tetë (8), ndërsa U.D i Sekretarit të Përgjithshëm me Vendimin numër:2-1312 të datës 06.04.2017 ia ka ngrit ankuesit koeficientin nga tetë (8) në nëntë (9) dhe po ashtu ankuesit i është lëshuar edhe Akti Emërimi i ri me datë 06.04.2017 me koeficient nëntë (9) në pozitën e njëjtë të punës.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi i ishte drejtuar me shkresë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 26.04.2017 ka nxjerrë rekomandimin me numër:2-1312 duke e bërë përgjegjëse Divizionin e Burimeve Njerëzore për Zbatimin e Vendimin numër:2-1312 të datës 06.04.2017 të U.D të Sekretarit të Përgjithshëm përmes të cilit vendim ankuesit i ishte ngrit koeficienti nga tetë (8) në nëntë (9).

Bazuar në listën e pagave për periudhën kohore nga muaji janar deri në muajin tetor 2019, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pavarësisht që ankuesit i ishte ngritur koeficienti me Vendim të U.D Sekretarit të Përgjithshëm sikurse dhe i ishte ndryshuar edhe Akti i Emërimit, i njëjti që nga datat 06.04.2017 ka vazhduar të paguhet sipas koeficientit tetë (8) deri me datë 31.09.2019, ndërsa pasi që ankuesit paga e muajit tetor 2019 i kishte dal me rritje, i njëjti me datë 01.11.2019 me kërkesë i ishte drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm për kompensim e diferencës në pagë për vlerën e një (1) koeficienti për periudhën kohore nga data 06.04.2017 prej momentit kur i ishte ngritur koeficienti, deri me date 31.09.2019, pas së cilës datë ankuesi kishte filluar të paguhet sipas koeficientit nëntë (9).

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kërkesën e ankuesit të datës 01.11.2019 e ka refuzuar me datë 14.11.2019, mirëpo refuzimi ka ndodhur vetëm si mbishkrim në kërkesën e njëjtë të datës 01.11.2019, pa dhanë asnjë arsytim apo pa nxjerrë ndonjë akt administrativ siç përcaktohet me dispozitat e dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 44 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1. Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike" andaj edhe në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj konstatohet fakti se refuzimi i kërkesës së ankuesit për kompensimin retroaktiv nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm me datë 14.11.2019, nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç janë pjesa hyrëse, pjesa urdhëruese, pjesa arsyetuese dhe pjesa përmblylëse, respektivisht akti i kontestuar me këtë ankesë nuk e përmbush as kriterin e përcaktuar me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim", ngase është e pamundur të arsyetohet dhe konstatohet fakti se mbi bazën e cilave dispozita ligjore,



Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it i ka refuzuar ankuesit kërkesën për kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive të diferencës në pagë në vlerën e një (1) koeficienti, pasi që ankuesit që nga data 06.04.2017 i është lëshuar Akti Emërimi i ri me koeficient nëntë (9) sipas Vendimit me numër:2-1312 të U.D të Sekretarit të Përgjithshëm të datës 06.04.2017, gjegjësisht edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 26.04.2017 e kishte rekomanduar Divizionin e Burimeve Njerëzore që të zbatojë Vendimin numër:2-1312 të datës 06.04.2017 të U.D të Sekretarit të Përgjithshëm përmes të cilit vendim ankuesit i ishte ngrit koeficienti nga tetë (8) në nëntë (9), sikurse është konstatuar fakti se ankuesi që nga muaji tetor 2019 ka filluar të paguhet sipas koeficientit nëntë (9) bazuar në Akt Emërimin e datës 06.04.2017 dhe se me rastin e refuzimit të kërkesës së ankuesit, Sekretari i Përgjithshëm me datë 14.11.2019 asnjëherë nga këto fakte dhe rrethana nuk i ka marr parasysh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ka ardhur në përfundimin se përgjigja refuzuese e Sekretarit të Përgjithshëm e datës 14.11.2019 është e kundërligjshme siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", pasi që veprimi administrativ i Sekretarit të Përgjithshëm i goditur me këtë ankesë është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës së përgjithshme administrative dhe ligjit material, dhe si e tillë përgjigja refuzuese e datës 14.11.2019 është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili ka qenë i zbatueshëm për periudhën e kohore të cilës i jemi referuar në këtë vendimi, respektivisht nenin 43 paragrafi 1 dhe neni 44 i këtij ligji ka përcaktuar se: "43.1. E drejta për trajtim të barabartë dhe mundësi të barabarta për zhvillim të karrierës-Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike; 44. E drejta për pagë-Puna e nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave, i cili rregullohet me ligj të veçantë" si dhe neni 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....", Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 21.11.2019 është bazuar, ngase ankuesi është dashur të paguhet sipas koeficientit nëntë (9) sipas Akt Emërimin të datës 06.04.2017.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji thekson faktin se Sekretari i Përgjithshëm i MASHT dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me rastin e pranimit të këtij vendimi, janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative me qëllim që ankuesit t'ia bëjnë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 06.04.2017 deri me datë 31.09.2019 për diferencën pagës në vlerën e një (1) koeficienti nga tetë (8) në nëntë (9).



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.727/2019

**Flakron GASHI**

*Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Arkivit të KPMSHCK- së.